

PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Sot pasdite (e premte, dt. 09) dhe nesër (e shtunë, dt. 10) do të ketë reshje me intensitet të lartë. Në qarqet Shkodër Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve.

Sipas llogaritjeve hidrologjike të IGJEO-s, si rezultat i reshjeve me intensitet të lartë (e premte, dt. 09) dhe nesër (e shtunë, dt. 10) pritet një rritje e prurjeve dhe niveleve në lumenjtë Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Seman. Rrezik të shtuar për përmbytje, në vazhdim të ditës së sotme dhe nesër, do të kenë lumi Vjosë, lumi Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës.

DËBORA DHE NGRICA

Sot (e premte, dt. 09) dhe nesër (e shtunë, dt. 10) reshjet e dëborës pritet të përfshijnë zonat në Veri, Lindje dhe Juglindje në territorit. Reshjet e dëborës të pasuara nga ulja e ndjeshme e temperaturave dhe ngricat mund të krijojnë probleme të ndryshme dhe vështirësi në transportin rrugor.

PARASHIKIMI METEO

RESHJET

Sot pasdite (e premte, dt. 09) dhe nesër (e shtunë, dt. 10) në qarqet Shkodër Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë priten reshje intensive, ndërsa në qarqet e tjera priten reshje mesatare. Reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në Veri, Lindje dhe Juglindje në lartësitë mbi 600 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

TEMPERATURA

Nesër (e shtunë, dt. 10) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 7 / 14 °C

në vendet e ulëta: 6 / 13 °C

në vendet malore: -1 / 7 °C

ERA

Sot pasdite (e premte, dt. 09) dhe nesër (e shtunë, dt. 10) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë në bregdet dhe në zonat malore.

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)

Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 09/ 2026, 09-01-2026

Parashikimi nga 09-01-2026, ora 12:00 deri 10-01-2026, ora 23:59.

NIVELET E RREZIKUT

S'KA RREZIK

I ULËT

I MODERUAR

I LART

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive					
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive					
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	intensive					
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive					
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive					
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare					
VLORE	S'KA RREZIK	intensive					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive					



Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Specialist: Indrit Rexhepi

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)


faqe 2 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 09 / 2026, 09-01-2026****Parashikimi** nga 09-01-2026, ora 12:00 deri 10-01-2026, ora 23:59.**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 09–10.****SIMBOLE**

	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke